

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-223/14

Prishtinë

1 Shkurt 2017

Në çështjen juridike të:

S. B.

Pala ankuese

kundër

S. S.

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/140/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA92055), i datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 1 Shkurt 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e pasafatshme ankesa e S. B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/140/2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA92055..

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 26 dhjetor 2006, S. S. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në emër të të ndjerit, babait të tij, M. S., ku ka kërkuar ri posedimin e ngastrës kadastrale nr. 1977, me kulturë tokë kultivuese me sipërfaqe prej 00.43.86 ha, që ndodhet në vendin e quajtur “Kovilevine”, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Pala përgjegjëse në ankesë ka thënë se babai i tij i ndjerë ishte pronar i pronës së kërkuar e cila është e uzurpuar nga një person i panjohur.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur këto dokumente:
 - Certifikatën e lindjes me nr. 200-1034, e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Komunën e Klinës, e datës 10 qershor 1999, që tregon lidhjen familjare në mes të palës përgjegjëse në ankesë dhe M.S..
 - Certifikatën e vdekjes nr. 203-548, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil e Komunës së Klinës, e datës 25 mars 1997, që tregon se M. S. ka vdekur më 22 korrik 1991 në Kijevë, Komuna e Klinës.
 - Fletën poseduese nr. 46, të lëshuar nga Zyra e Gjeodezisë së Republikës, Qendra e Kadastrit për Pronën e Paluajtshme në Prishtinë, Zyra e Kadastrit për Pronën e Paluajtshme në Klinë, e datës 28 gusht 2002, ku cekët se prona e kërkuar është në emër të M. S.
 - Certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme UI-72310037-00046, të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Malishevë, e datës 17 maj 2007, që tregon se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të tre bashkëpronarëve (N., S. dhe N. S.).
 - Certifikatën e vdekjes nr. 203-1-700/2011-VII, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil e Komunës së Kragujevcit që tregon se N. S. ka vdekur më 5 shkurt 2011, në komunën e Kragujevcit.

3. AKP-ja ka bërë identifikimin e kërkesës më 28 dhjetor 2010. Procesi i identifikimit është kryer duke e bërë publikimin e kërkesës në Gazetën për Njoftim nr. 10 të AKP-së dhe në Buletinin e Zyrës për Prona të UNHCR-it. Gazeta dhe lista janë lënë në të gjitha komunat dhe Gjykatat Komunale në Regjion dhe në Zyrën Kadastrale, UNHCR, CPRK, EULEX, OMBUDSPERSON dhe ICO.
4. Asnjë palë e interesuar nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesë brenda afatit prej 30 ditëve, kështu që kërkesa është konsideruar si e pa-kontestuar.
5. Sekretaria ekzekutive e AKP-së, e ka siguruar *ex officio*, certifikatën për të drejtën e pronës së paluajtshme UL-72310037-00046, të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Malishevë, më 10 shtator 2007, ku prona e kërkuar figuron në emër të palës përgjegjëse në ankesë dhe të vëllezërve të tij N. dhe N. S., në cilësinë e bashkëpronarëve, secili me nga 1/3 pjesë ideale. Ndryshimet janë bërë në vitin 2007, në bazë të Aktvendimit për Trashëgiminë nr. 5/2007.
6. Më 29 shkurt 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin KPCC/D/A/140/2012 e ka miratuar kërkesën në emër të vëllait të palës përgjegjëse në ankesë, N. S., duke cekur se pala përgjegjëse në ankesë e ka vërtetuar se vëllai i tij N. S., është bashkëpronar i 1/3 pjesë ideale të pronës së kërkuar.
7. Vendimi i KKKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 2 korrik 2012.
8. Vendimi i KKKPK-së i është dorëzuar S. B., në cilësinë e palës së interesuar, më 14 gusht 2014. Ai ka paraqitur ankesë më 17 shtator 2014 (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese)

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese thekson se vendimi i KKKPK-së është i bazuar në shkeljen e së drejtës materiale dhe procedurale, si dhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
10. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se informatat e paraqitura në vendimin e KKKPK-së janë të pabazuara pasi që S. S.ia ka shitur pronën e kërkuar H. K. nga fshati Bubaves, më 1 korrik 1997, në bazë të kontratës për shitblerje. Çmimi i blerjes ishte 12.000 DM (marka gjermane). Kontrata e shitblerjes është nënshkruar nga shitësi, blerësi dhe dëshmitarët në vijim: N. S., V.Vučković, R. K. dhe Ž.V.
11. Sipas palës ankuese, shkelja thelbësore e dispozitave ligjore bazohet në faktin se vendimi i KKKPK-së është marrë gabim në mungesë të palës e cila e ka në posedim dhe shfrytëzim pronën qysh nga nënshkrimi i kontratës së shitblerjes. Pas një kohe, H. K., blerësi i pronës së kërkuar, e ka ndërruar pronën e kërkuar me palën ankuese, i cili është në posedim dhe shfrytëzim të pronës nga viti 1997, por për shkak të regjimit serb nuk ka qenë në gjendje ta bart pronën e kërkuar në emrin e vet.

12. Në bazë të mësipërmes, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që pas vlerësimit të provave të merr një aktgjykim të bazuar në meritat dhe ta njeh të drejtën pronësore në emrin e palës ankuese në bazë të kontratës për shitblerje të ngastrës kadastrale nr. 1977 me sipërfaqe prej 00.43.86 ha, të regjistruar në fletën poseduese nr. 45, që ndodhet në rrugën “ Kovilevine”, Komuna e Malishevës.
13. Për t'i mbështetur pretendimet e tij, pala ankuese ka dorëzuar këto prova:
 - Kontratën e shitblerjes. Kontrata nuk shihet qartë.
 - Letërnjoftimin e palës ankuese të lëshuar më 16 shkurt 2010, nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.
 - Autorizimin LRP Nr 2811/2014, të vërtetuar nga noteri, I. E.më 23 qershor 2014, përmes së cilit pala ankuese e autorizon avokatin, A. K., që ta përfaqësojë para institucioneve kompetente dhe gjykatës lidhur me vërtetimin e së drejtës pronësore.
14. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 29 tetor 2014. Ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.
15. Më 6 prill 2016, urdhri i gjykatës i është dorëzuar palës ankuese, duke kërkuar nga ky i fundit të dorëzojë në Gjykatën Supreme, një kopje të lexueshme të kontratës së shitblerjes e lidhur në mes të palës përgjegjëse në ankesë (S. S.) dhe H.K.
16. Më 5 maj 2016, pala përgjegjëse në ankesë i është përgjigjur urdhrin të gjykatës duke e dorëzuar kontratën e shitblerjes, megjithatë, kontrata nuk është e vërtetuar në gjykatë, por si e rëndësishme kryesore është që prona e kërkuar nuk është objekt i kontratës, dhe përveç sipërfaqes prej 00.12.00 ha, nuk ka asgjë tjetër të specifikuar në kontratë.

Arsyetimi ligjor

17. Ankesa është e pasafatshme. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 duke ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, parasheh si në vijim: *“brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*
18. Pala përgjegjëse në ankesë e ka pranuar personalisht vendimin e KKPK-së, më 14 gusht (e enjte) 2014; afati i fundit për paraqitjen e ankesës ka përfunduar më 15 shtator 2014, pasi që dita e 30-të nuk ishte ditë pune. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesë vetëm më 17 shtator 2014, dy ditë pas afatit. Kjo nënkupton se ankesa është paraqitur pas afatit të paraparë me ligj.
19. Gjykata ka konstatuar se dërgimi është bërë personalisht në pajtim me nenin 110.1 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008). Pala

ankuese nuk ka ofruar asnjë arsytim për vonesën e paraqitjes së ankesës, dhe as gjykata nuk ka mundur të gjejë asnjë arsye për vonesën në dosje të lëndës.

20. Prandaj ankesa hidhet poshtë si e pasafatshme sipas nenit 186 lidhur me nenin 196 të baza të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtojë meritat e ankesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, gjyqtar

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it